

Ndihma ligjore në fushën administrative e civile.

Aktualisht shteti shqiptar nuk e sheh vehten të lidhur me detyrime të drejtëpërdrejta në sigurimin e aksosit në drejtësi përmes ofrimit të ndihmës ligjore në fushën civile. Por angazhimet ndërkombe të Republikës së Shqipërisë kanë krijuar kushtet dhe kanë bërë të domosdoshëm nevojën për parashikimin e ndihmës ligjore edhe për këtë fushë në vendin tonë.

Edhe pse për momentin direktivat e KE nuk kanë karakter detyrues ato duhet të konsiderohen nga Republika e Shqipërisë si akte të cilave duhet t'i referohet në rrujan e gjatë e përafrimt të legjislacionit vendas me atë BE.

GJEDNJ² nënizon se ofrimi i ndihmës ligjore në fushën civile është shumë i gjërë. Ajo rikonfirmon se ndihma ligjore mund të kërkohet edhe në procesin civil në bazë nenit 6§1 të KEDNJ³.

Në kushtetutë e Republikës së Shqipërisë, janë hedhur bazat kryesore të cilat kushtëzojnë pjesmarrjen e shtetit në ofrimin e ndihmës ligjore në fushën civile dhe konkretisht:

² Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, GJEDNJ

³ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, KEDNJ, ratifikuar nga Shqipëria në 1996

Nëse ju kërkonin informacione të mëtejshme ose këshillime, Ju lutem na kontaktoni në :
SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË
Rruja "Sami Frashëri",
4 kllat sezioni III, Ap 1A
Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 4 253 114, Tel/Fax: 00355 4 258 442
www.tlas.org.al



- ▶ **Neni 3:** Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.
- ▶ **Neni 18/1:** Të gjithë janë të barabartë përparrë ligjit.
- ▶ **Neni 42/2:** Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundërt tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

A është e mundur që çdo individ është akses në drejtësi?

Aksesi në drejtësi duhet t'i garantohet çdo individi. Por aksesi në drejtësi përmes ndihmës ligjore do të thotë sigurimi i shërbimeve ligjore të nevojshme për të gjithë individët, edhe për ata të cilët nuk i arrijnë dot ngaqë:

- Kanë vështirësi për të gjetur, njohur apo kuptuar ligjin.
- E kanë të pamundur të përballojnë shpenzimet e një procesi gjyqorë (shpenzimet e avokatit, taksat e gjykatës apo tarifat e ekspertit etj)
- Kanë paaftësi fizike apo mendore.

Cilët janë aktorët që bëjnë të mundur realizimin e aksesit në drejtësi?

Aktorët që bëjnë të mundur realizimin e aksesit në drejtësi janë personeli i administratës shtetërore, i gjykatave, i DhKA, i OFJ-ve.

Nëpërmjet shërbimeve që ato i ofrojnë publikut luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e aksesit në drejtësi.

Cilësia e shërbimit për të komunikuar me pasion, respekt dhe mirësellje me publikun, veçanërisht me ata që janë në nevojë, varet nga kushtet në të cilat punonjësit e ofrojnë shërbimin si dhe nga trajnimë i vazhdueshëm profesional i tyre.



Botimi i këtij materiali është mbështetur finanziarisht nga programi i granteve të vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mëndimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Çfarë është aksesi në drejtësi?



Aksesi në drejtësi është mundësia që ka çdo individi përtu trajtuar i barabartë përparrë ligjit dhe përtë gjëzuar një mbrotje sa më efektive të të drejtave dhe lirive themelore. Shteti duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme përtë informuar qytetarët mbi mjetet e nevojshme për realizimin e të drejtave të tyre në organet e administratës publike apo në gjykatë.

Aksesi në drejtësi ndër të tjera është akses në shërbime ligjore që përfshijnë informacion, këshillim, përgatitje dokumentash dhe përfaqësim.

Organet shtetërore të ngarkuara nga ligji përofrimin e shërbimeve publike janë të detyruar të krijojnë kushe që ky shërbim të jetë i aksesueshëm nga çdo individ pavarësisht nga kufizimet e tij për shkak të gjendjes ekonomike, gjuhës apo nivelit arsimor e kulturor.

Aksesi në drejtësi është i lidhur ngushtë me ofrimin ndihmës ligjore falas. Koncepti i ndihmës ligjore¹ përfshin tërësi shërbimesh ligjore që i ofrohen individëve në nevojë.

¹ Kur përmendim termin "ndihmë" ligjore, nënkuqtojm ndihmën ligjore Falas



Ndihma ligjore në Drejtësi dhe Ndihmës Ligjore

Në një shoqëri të organizuar sipas parimeve demokratike detyra parësore e shtetit është të sigurojë respektimin e lirisë individuale dhe epërsisë të së drejtës. Këto qëllime të larta nuk mund të realizohen nëse shteti nuk garanton barazinë përparrë ligjit të të gjithë individëvë të tij, si gurë themelor i shtetit të së drejtës. Krijimi i kushteve që çdo individ të këtë akses në drejtësi është një nga detyrat kryesore të shtetit përtë siguruar dhe garantuar parimin e barazisë përparrë ligjit.

Ndihma ligjore është instrumenti më efikas përti garantuar individit aksesin në drejtësi. Përmes ndihmës ligjore çdo individ në pamundësi financiare mund të marrë mbështetjen e nevojshme për realizimin e të drejtave të tij

Nisur nga rëndësia që ka aksesi në drejtësi si element kryesor i shtetit të së drejtës, ai gjen rregullim si në aktet kryshore të shtetit (kushtetuta dhe ligjet) ashtu edhe në aktet ndërkombëtare të cilat janë të detyrueshme përtuzbatuar.

Ndihma ligjore në fushën penale

Sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatish me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme"

Sipas nenit 42 të Kushtetutës

1. "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor."
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Ndihma ligjore në fushën penale

► **Neni 49 "7"** Kodit të Procedurës Penale "Kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen paguhen nga shteti".

► **Neni 49 "2"** Kodi i Procedurës Penale "Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike ose psikike që e pengojnë përtë realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme".

► **Neni 11** Ligjet Nr.9109 datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë":

"Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:
b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore përtë eshtë falas.

